FEDERATA ESPORTS KOSOVA

RAPORT PËRMBLEDHËS I PUNËS SË KOMISIONIT DISIPLINOR

PËR PERIUDHËN JANAR – GUSHT 2026

Data e raportimit	25.08.2026
Periudha e raportimit	01.2026 – 25.08.2026
Komisioni	Komisioni Disiplinor i FESK-së
Selia	Prishtinë, Republika e Kosovës

1. HYRJE

Ky raport paraqet në mënyrë të përmbledhur punën dhe veprimtarinë e Komisionit Disiplinor të Federatës Esports Kosova (FESK) për periudhën 01 janar – 30 shtator 2026. Raporti është hartuar me qëllim të dokumentimit të funksionalizimit të mekanizmave disiplinorë të Federatës, transparencës institucionale dhe pasqyrimit të rasteve të trajtuara gjatë periudhës raportuese.

2. BAZA LIGJORE DHE STATUTORE

Komisioni Disiplinor ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Statutin e Federatës Esports Kosova, rregulloret dhe aktet e brendshme të Federatës, si dhe me legjislacionin në fuqi për sportin në Republikën e Kosovës.

Komisioni Disiplinor është funksionalizuar me Vendimin e Bordit të Federatës, të datës 29.03.2026, në mbështetje të nenit 12, paragrafëve 1, 2 dhe 3, pika XII të Statutit të FESK-së.

3. FUNKSIONALIZIMI DHE PËRBËRJA E KOMISIONIT

Me Vendimin e Bordit të Federatës të datës 29.03.2026 është formuar Komisioni Disiplinor me tre anëtarë:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Funksioni
1.	Dardan Makolli	Kryesues
2.	Ymer Mehmeti	Anëtar
3.	Faton Polisi	Anëtar

4. QËLLIMI DHE PËRGJEGJËSITË

• Shqyrtimi i çështjeve dhe shkeljeve të mundshme disiplinore brenda kompetencave të përcaktuara me Statut dhe aktet e FESK-së.

• Sigurimi i trajtimit të drejtë dhe objektiv të rasteve disiplinore.

• Respektimi i të drejtës së palëve për t'u informuar, për t'u dëgjuar dhe për të ushtruar të drejtën e ankesës, sipas rregullave në fuqi.

• Propozimi ose marrja e masave disiplinore në pajtim me kompetencat e përcaktuara nga Statuti dhe aktet përkatëse.

• Mbajtja e evidencës së rasteve, vendimeve dhe dokumentacionit përkatës.

5. VEPRIMTARIA GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periudhës raportuese, Komisioni Disiplinor ka pasur në fokus ruajtjen e zbatimit të rregullave dhe standardeve të përcaktuara nga FESK, si dhe monitorimin e respektimit të rregullave në aktivitetet dhe garat e organizuara ose të mbështetura nga Federata.

Komisioni është funksionalizuar më 29.03.2026. Për periudhën nga data e funksionalizimit deri më 30.09.2026, nuk janë evidentuar raste formale disiplinore të paraqitura për shqyrtim nga Komisioni, dhe për rrjedhojë nuk është nxjerrë vendim disiplinor.

6. PASQYRA E RASTEVE DISIPLINORE

Kategoria	Numri
Raste të pranuara për shqyrtim	0
Procedura disiplinore të iniciuara	0
Raste të shqyrtuara	0
Vendime disiplinore të nxjerra	0
Masa disiplinore të shqiptuara	0
Raste të mbyllura	0
Ankesa ndaj vendimeve disiplinore	0

7. KONSTATIME

• Komisioni Disiplinor është themeluar dhe funksionalizuar me vendim të Bordit të FESK-së.

• Komisioni ka përbërje prej tre anëtarësh, në pajtim me vendimin për themelimin e tij.

• Gjatë periudhës nga funksionalizimi i Komisionit deri më 23.09.2026 nuk janë regjistruar raste formale disiplinore për shqyrtim.

• Nuk janë shqiptuar masa disiplinore dhe nuk janë paraqitur ankesa ndaj vendimeve disiplinore gjatë kësaj periudhe.

• FESK mbetet e përkushtuar ndaj respektimit të rregullave, fair-play-it, etikës sportive dhe procedurave të përcaktuara me aktet e saj.

8. PËRFUNDIM

Bazuar në dokumentacionin dhe evidencat e Komisionit Disiplinor, për periudhën e raportimit 01.01.2026 – 30.09.2026 nuk rezulton të ketë pasur raste disiplinore formale të trajtuara nga Komisioni. Komisioni do të vazhdojë të ushtrojë përgjegjësitë e tij në përputhje me Statutin, rregulloret dhe aktet e tjera të FESK-së, duke garantuar trajtim objektiv, transparent dhe të dokumentuar të çdo rasti eventual.

9. TRANSPARENCA DHE PUBLIKIMI

Data e miratimit	17.09.2026

Data e publikimit	26.08.2026
Platforma	Faqja zyrtare e Federatës Esports Kosova

10. ANEKSE / DËSHMI MBËSHTETËSE

- Vendimi i Bordit për rizgjedhjen e anëtarëve të rinj të Komisionit Disiplinor, datë 29.03.2026.
- Procesverbali i mbledhjes së Bordit të Federatës, datë 29.03.2026.
- Evidenca e rasteve disiplinore për periudhën raportuese.
- Dëshmia e publikimit të raportit në platformën digjitale të FESK-së.

PËRGATITUR NGA KOMISIONI DISIPLINOR I FESK-së

Emri dhe mbiemri	Funksioni	Nënshkrimi
Dardan Makolli	Kryesues	
Ymer Mehmeti	Anëtar	
Faton Polisi	Anëtar	

